



MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



KONFERENCA  
***Diaspora Flet***

ANALIZË E SHKURTËR E POLITIKAVE MBI  
**VOTIMIN JASHTË VENDIT**

Maj 2018

---

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Germin dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

**Të gjitha të drejtat janë të rezervuara**

© 2018 Germin

Pa lejen me shkrim nga Germin asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rrikthimi, të transmetohet në ndonjë formë ose me çfarëdo mjeti elektronik, mekanik, fotokopjimi, incizimi ose ndryshe.

Prishtinë, 2018

## Analizë e shkurtër e politikave për votimin jashtë vendit për Diasporën

---

### I. Situata aktuale

Diaspora e Kosovës vazhdon të luajë një rol kyç për ekonominë me anë të remitencave. Dërgesat financiare nga jashtë përbëjnë rreth 15% të bruto prodhimit vendor (GDP), sipas të dhënave nga UN dhe Banka Botërore. Përfshirja e diasporës në proceset politike, posaçërisht në votim, është e garantuar me ligj. Sidoqoftë, pengesa të ndryshme teknike, administrative dhe ligjore vështirësojnë pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale dhe qendrore. Rreth 300,000 njerëz në diasporë kanë të drejtë vote në zgjedhjet në Kosovë, sipas Democracy for Development. Në zgjedhjet qendrore të parakohshme në qershor 2017, vetëm 20,354 (6.8%) e diasporës ka aplikuar për t'u regjistruar për votim. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar 15,118 aplikacione për regjistrim. Megjithatë, vetëm 5,949 (30% të aplikacioneve) kanë dërguar fletëvotimet dhe 5,246 nga to janë pranuar si vota valide. Ngjashëm ishte edhe pjesëmarrja në zgjedhjet lokale dhe balotazhin në tetor dhe nëntor 2017 që u karakterizuan me pjesëmarrje të ulët nga diaspora. Dallimi i madh mes numrit të përgjithshëm të atyre me të drejtë vote dhe numrit të votave tregon për nevojën e lehtësimit të votimit nga jashtë dhe nevojën për shqyrtim të metodave alternative të votimit, përveç asaj me postë (shih grafikën 1).

Për të matur perceptimet e komunitetit të Diasporës në lidhje me të drejtën e votës, OJQ Germin ka zhvilluar një anketë me **232 pjesëtarë** të këtij komuniteti, ku pjesa dërrmuese e të anketuarve thanë se kanë ardhur në vendlindje për të votuar (73%). Pjesa më e madhe e të anketuarve të cilët nuk kishin votuar fare në ndonjë nga zgjedhjet e zhvilluara në vendet e origjinës, deklaruan se arsyeja përse nuk kishin votuar ishte mungesa e informatave (44%). Kurse, gjatë takimeve (grupeve të fokusit, ngjarjeve DiasporaFlet) me diasporën si dhe takimet virtuale/Google hangouts, organizata Germin ka mbledhur propozime për përmirësimin e votimit nga diaspora. Ka disa metoda për votimin nga jashtë dhe më poshtë kemi theksuar përparësitë dhe sfidat e tyre:

### Votimi me postë

- Votimi me postë është i lehtë, relativisht i lirë dhe mundëson qasje të barabartë për diasporën në mbarë botën. Sidoqoftë, kohëzgjatja e dërgesave postare paraqet një sfidë për zbatim të suksesshëm të kësaj metode votimi, sidomos kur zgjedhjet janë të jashtëzakonshme dhe në të cilat kompensohen afatet kohore. Aktualisht, KQZ kërkon që fletëvotimet të arrijnë në zyrat e tyre më së largu deri ditën e zgjedhjeve. Zgjatja e periudhës për pranimin e votave nga diaspora për një apo dy ditë do të ngritë numrin e votave të pranuar si valide, por kjo kërkon ndryshime ligjore. Një alternativë do të ishte pranimi i votave nga KQZ edhe dy ditë pas zgjedhjeve me kusht që fletëvotimet të jenë futur në postë para ditës së zgjedhjeve (duke u bazuar në vulën postare nga vendi dërgues). Shpërndarja e ngadaltë e postës rezulton në refuzimin e shumë votave që

nuk arrijnë me kohë në KQZ. Fletëvotimet nga diaspora zakonisht nuk numërohen në mbrëmje pasi që mbyllen vendvotimet brenda vendit por të nesërmen apo disa ditë më vonë. Prandaj, zgjatja e periudhës për pranimin e fletëvotimeve që veçse janë futur në postë nuk do të shkaktonte ndonjë pengesë të madhe administrative.

- Sipas rregullave të KQZ-së, votuesit poashtu duhet të fusin një kopje të pasaportës apo letërnjoftimit për konfirmim të identitetit së bashku me fletëvotimin në zarf të ndarë dhe t'i dërgojnë në një paketë të vetme. Disa votues janë skeptik nëse sekretet e votës dhe anonimiteti respektohen gjatë numërimit. KQZ do të mund t'i adresonte këto brenga duke ofruar detaje se si numërohen votat e diasporës. Transparenca e këtij procesi do të përmirësohej nëse paketat/zarfet me vota hapen nën vëzhgimin e drejtpërdrejtë të kamerave për të garantuar numërim të saktë.

### **Votimi në misionet diplomatike dhe konsullore të Kosovës**

- Kosova ka përfaqësim diplomatik apo konsullor në 25 vende të ndryshme. Disa nga këto misione diplomatike do të mund të organizonin votimin për diasporë me planifikim dhe mbështetje nga KQZ. Votat do të numëroheshin aty për aty nën vëzhgimin e një përfaqësuesi nga KQZ apo do të mund të dërgohen me një zarf të vetëm dhe të sigurt në Kosovë. Përzgjedhja e një ambasade/konsullate për një rajon të caktuar që do të përfshinte disa shtete do të ndihmonte që një numër i madh i votuesve nga diaspora të udhëtonte një distancë jo shumë të gjatë për të votuar. Kjo do të kursente kohë dhe para pasi që votuesit nga diaspora nuk do të kishin nevojë të vinin në Kosovë. Kjo metodë mundëson mbrojtjen e sekretit të votës, por kërkon më shumë planifikim administrativ dhe kapital njerëzor për të organizuar votimin në misionet diplomatike. [Maqedonia, për shembull](#), ka zbatuar këtë metodë në disa zgjedhje. Përzgjedhja e një ambasade (p.sh. Bernë apo Berlin) si pilot projekt për testimin e kësaj metode do të shërbente për të shqyrtuar më mirë potencialin dhe vështirësitë e votimit në misionet diplomatike.

### **Votimi elektronik**

- Votimi elektronik nga diaspora do të ishte i shpejtë dhe efikas. Sidoqoftë, teknologjia informative, infrastruktura dhe masat përcjellëse të sigurisë paraqesin sfida serioze për zbatim të suksesshëm. Ndërhyrja nga aktorë të jashtëm në procesin zgjedhor, siç ka ndodhur në disa vende, paraqet një rrezik të lartë për manipulim të rezultateve. Votimi elektronik është posaçërisht i rrezikuar nga pirateria informatike (hakim) apo manipulimi digjital. Përgatitja e një sistemi nga zeroja që do të mbronte informatat e votuesve dhe transmetimin e të dhënave është e komplikuar. Poashtu, nevojitet një kornizë ligjore për caktimin e kriterëve për identifikimin e votuesve (për shembull lexues të menqur/smart të letërnjoftimeve) që do të përdoronin votimin elektronik. Estonia është një shtet ku një e katërta e votuesve përdorin internetin për të votuar dhe mund të shërbejë si shembull studimi i mundshëm për Kosovën për të vlerësuar potencialin dhe sfidat e votimit elektronik.

## **Votimi me autorizim**

- Kjo metodë do të lejonte votuesit nga diaspora që të autorizojnë dikë në Kosovë të votojnë në vend të tyre. Përderisa në parim kjo metodë nuk ka kosto të lartë, ky lloj votimi karakterizohet me pengesa administrative për konfirmimin e identitetit të votuesit dhe personit të autorizuar.

Votimi nga jashtë, varësisht nga metoda, është proces më i kushtueshëm sesa votimi brenda vendit. [Sipas të dhënave nga International Foundation for Electoral Systems \(IFES\)](#), kostoja për votim brenda vendit është rreth \$2 për person, ndërsa votimi nga jashtë kushton prej \$5 deri në \$20 për person. Këto përfshijnë pagesën postare, shpenzime administrative shitesë për trajnimin e stafit, hapjen e konsullatave dhe procese tjera më të komplikuar për regjistrimin e verifikimin e votuesve. Poashtu, votimi nga jashtë kërkon më shumë kohë për regjistrim, votim dhe numërim. Për këto arsye, buxheti dhe kohëzgjatja duhet të jenë prioritete për KQZ dhe akterët tjerë relevantë.

Ne sugjerojmë që regjistri i votuesve të diasporës të vazhdojë të jetë i ndarë nga regjistri kryesor. Aktualisht, KQZ kërkon që votuesit nga diaspora të regjistrohen çdo herë para zgjedhjeve. Për shembull, nëse dikush është regjistruar dhe ka votuar me sukses në zgjedhjet parlamentare në qershor 2017, ai/ajo është dashur të dërgoj aplikacionin për regjistrim përsëri për të votuar në zgjedhjet lokale në tetor. Ky parakusht administrativ mund të jetë dekurajues dhe ulë numrin e votuesve të regjistruar. Sipas anketës së realizuar nga Germin, ankesë tjetër e paraqitur nga disa të anketuar ishte se emrat e disa anëtarëve të Diasporës nuk figuronin në listat zgjedhore. Sipas tyre, burimi kryesor i këtyre pengesave është KQZ dhe korrupsioni i subjekteve politike në vendet amë. Kur u pyetën se si mund të tejkalohen këto probleme, disa nga të anketuarit thanë duhet të ketë përfaqësim të Diasporës në Kuvend në vendet amë, si dhe të ofrohen më shumë informata rreth procesit të votimit. Për këtë, KQZ do të mund të zbatonte metodën "opt-out": votuesi që regjistrohet njëherë në regjistrin e diasporës do të mund të votojë në zgjedhjet pasuese pa pasur nevojë përsëri për regjistrim. Nëse një votues nga diaspora planifikon të udhëtojë në Kosovë për votim, atëherë do të ishte përgjegjësi e votuesit që ta njoftojë KQZ-në më kohë për t'u larguar nga regjistri i diasporës dhe të transferohet në regjistrin e përgjithshëm.

Ne poashtu duam të theksojmë çështjen e privatësisë gjatë publikimit nga KQZ të listave të votuesve të diasporës. Këto lista përmbajnë datat e plota të lindjes dhe numrat personal të personave që janë regjistruar për votim. Ne propozojmë që të dhënat personale të redaktohen pjesërisht para publikimit për të mbrojtur privatësinë dhe evituar vjedhjen e mundshme të identitetit.

Bëjmë thirrje që KQZ të zgjerojë përpjekjet për komunikim me diasporën duke shfrytëzuar rrjetet e ambasadave dhe organizatave të ndryshme në diasporë për vetëdijësim rreth procesit

të votimit. Spotet informative në transmetuesin publik RTK si dhe fushata vetëdijesuese në media sociale, pikat kufitare, aeroport dhe portale të lajmeve do të kishin një efekt më të madh.


KQZ dhe Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike do të duhej të punojnë ngushtë së bashku për të përditësuar rregullisht regjistrin e votuesve nga jashtë. Regjistri i diasporës që u inicia dhe mirëmbahet nga Ministria mund të shërben për të kontaktuar një numër më të madh të diasporës. Poashtu, do të ishte e dobishme nëse regjistrimi i votuesve nga diaspora të mund të bëhej vazhdimisht dhe jo vetëm gjatë cikleve zgjedhore.

Në planin afatshkurtër, sugjerojmë që KQZ të marrë parasysh çështjet lidhur me votimin me postë për të lehtësuar procesin dhe rritur numrin e votave. Zgjatja e afatit për pranimin e fletëvotimeve nga diaspora dhe transparenca gjatë numërimit do të përmirësonte votimin me postë. Në planin afatmesëm, propozojmë që të merren hapa për lansimin e votimit në disa ambasada. Së fundi, votimi elektronik është një alternativë tjetër por që kërkon shqyrtim të sfidave legjislativë dhe të sigurisë kibernetike për zbatim të suksesshëm. Miratimi i reformës zgjedhore në të ardhmen duhet të përfshijë këto çështje për lehtësimin e votimit dhe zbatimin e metodave alternative për votim.





MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK  
**DANIDA** | INTERNATIONAL  
DEVELOPMENT COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC**

Ky grant është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).